



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:044551
Datë: 08.05.2024
Numri i dokumentit: 05664017

PML.nr.282/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Agim Maliqi kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Valdete Daka anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të kërkuarit për ekstradim H. B., shtetas i Republikës së Kosovës i cili kërkohet nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë me qëllim të zhvillimit të procedurës penale për vepër penale sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje dhe prodhimi dhe armëmbajtja pa leje nga neni 80-25 dhe 278/1-25 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të kërkuarit për ekstradim, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, NJND.nr.3/2024 të datës 29.03.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.606/2024 të datës 18.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 08.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të kërkuarit për ekstradim H. B., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, NJND.nr.3/2024 të datës 29.03.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.nr.606/2024 të datës 18.04.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin NJND.nr.3/2024 të datës 29.03.2024, ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, dhe e ka lejuar ekstradimin e të kërkuarit për ekstradim H. B., për vazhdimin e procedurës penale për veprën penale prodhim dhe armëmbajtja pa leje nga neni 278/1-25 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.nr.606/2024 të datës 18.04.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të kërkuarit për ekstradim dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të kërkuarit për ekstradim H. B. av. Hasan Rexha, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë si të bazuar kërkesën dhe t'i anulojë aktvendimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthejë në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ndaj të kërkuarit për ekstradim të ndërpritet masa e paraburgimit.

Kryeprokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.121/2024 të datës 03.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të kërkuarit për ekstradim të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet nga kërkesa, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi thekson se aktvendimet e kundërshtuara janë në kundërshtim me të drejtën tonë pozitive, në shkelje themelore të lirisë dhe të drejtëve themelore të njeriut për arsye se vepra penale për të cilën është kërkuar për ekstradim – sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje sipas KPRK nuk është vepër e veçantë penale dhe nuk është e sanksionuar si vepër penale, prandaj mungon inkriminimi i dyfishtë dhe nuk mund të bëhet ekstradimi për këtë veprë penale. Sa i përket veprës penale prodhimi dhe armëmbajtja pa leje, nuk është ofruar asnjë provë materiale, prandaj në mungesë të provave materiale ligjërishit nuk mund të veprohet lidhur me ekstradimin. Dispozitivët dhe arsyetimi i aktvendimeve janë kundërthënës me përmbajtjen lidhur me faktet në shkresat e lëndës e po ashtu edhe me dispozitat e Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në Çështjet Penale (LBJNÇP), neni 9, i cili parasheh se ekstradimi lejohet vetëm për vepër penale të dënueshme sipas ligjit vendor, neni 12 i po këtij ligji parasheh se ekstradimi lejohet vetëm kur ekzistojnë prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar se personi ka kryer

veprën penale për të cilën kërkohet. Vepra penale sigurimi i kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje nuk është e sanksionuar me KPRK dhe për këtë veprë nuk mund të diskutohet ekstradimi, ndërsa për veprën penale prodhimi dhe armëmbajtja pa leje nuk ka prova materiale me të cilat do të vërtetohej se i kërkuari është i involvuar në çfarëdo forme me atë veprë penale. Sa i përket masës së paraburgimit, në dispozitat e KPP nuk ekziston instituti i paraburgimit pa afat andaj kjo masë ndaj të kërkuarit nuk ka bazë ligjore.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e lëndës rezulton se personi i kërkuar për ekstradim H. B., kërkohet nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, Kërkesa numër 1608/05 me numër protokollit S.B të datës 12.02.2024; Relacioni i datës 08.02.2024 i Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Berat.

Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, me datë 27.12.2022 është ratifikuar Marrëveshja mbi ekstradim. Mbështetur në marrëveshjen e arritur palët lejojnë dorëzimin tek njëra tjetra, sipas dispozitave dhe kushteve të përcaktuara me këtë marrëveshje, të gjithë personat kundër të cilëve autoritetet kompetente të palës kërkuese kanë filluar procedimin gjyqësorë për veprë penale ose personat që janë të kërkuar nga autoritetet e lartpërmendura për ekzekutimin e një vendimi apo urdhër arresti.

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ushtruar kërkesën NJN/1.nr.8/2024 të datës 23.02.2024, për lejueshmërinë e ekstradimit të tani të kërkuarit H. B., në bazë të nenit 18 par. 1 dhe 2 të LBJNÇP. Kërkesa për lejimin e ekstradimit është ushtruar në referim të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, e cila ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës ekstradimin e tani të kërkuarit H. B., me qëllim të zhvillimit të procedurës penale për veprë penale sigurimi i kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje si dhe veprë penale prodhimi dhe armëmbajtja pa leje nga neni 80-25 dhe 278/1-25 të KPRSH.

Me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, NJND.nr.3/2024 të datës 29.03.2024, është lejuar ekstradimi për të kërkuarin H. B. për vazhdimin e procedurës penale për veprën penale prodhim dhe armëmbajtja pa leje nga neni 278/1-25 të KPRSH, veprë penale kjo e paraparë edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës në nenin 366 par. 1 të KPRK.

Pasi që vepra penale sigurimi i kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje nga neni 80-25 të KPRSH nuk është e paraparë si veprë penale me KPRK, andaj ekstradimi për këtë veprë penale me të drejtë u refuzua nga gjykatat e instancave më të ulëta.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të KPP e as të LBJNÇP, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin e pretendimeve dhe kanë dhënë arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.282/2024 datë 8.5.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi